



## KOMUNIKATË

**30. 11. 2009**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e sotshme është informuar për aktivitetet që po bëhen në përgatitjen e Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune. Kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, pasi që i ka përshëndetur të gjithë të pranishmit, ka kërkuar nga KQZ miratimin e rendit të ditës. Pas miratimit të rendit të ditës, Kryeshefi i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), z. Xhemajl Peqani, e ka informuar KQZ-në lidhur me përgatitjet që po bëhen për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve.

Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, e ka njoftuar KQZ-në për takimet me mekanizmat siq janë Policia e SHPK-së, KFOR-i, Policia e EULEX-it, OSBE, IFES lidhur me koordinimin e aktiviteve për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve që do të mbahen me 13 dhjetor.

Prej datës 27 nëntor, një ekip nga SKQZ gjendet në Slloveni për monitorimin e procesit të prodhimit të Fletëvotimeve. Prej datës 29 nëntor, Zyrtarët Ekzekutiv të Komisioneve Komunale Zgjedhore janë në kontakt me subjektet politike që nëse ato kanë propozime për ndryshime të Këshillave të Vendvotimeve, t'i bëjnë ndryshimet më së lagru deri më 4 dhjetor. Propozimet për ndryshime, duhet të paraqiten për nominim nga KQZ më së largu deri më 6 dhjetor.

Kryeshefi i SKQZ-së, z. Peqani e ka informuar KQZ-në se, po bëhen pagesat sipas kontratave me operatorët ekonomik. Kompania "Dukagjini", sot ka filluar prodhimin e LPV-e për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve. Është duke u bërë edhe selektimi i stafit për QNR-në. Më 1 dhjetor, fillon faza e dytë e auditimit në KQZ, nga ana e zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës.

Koordinatori i Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), z. Burim Ahmetaj, e ka informuar KQZ-në për procesin e final të rezultateve. Në QNR ka përfunduar rinumërimi i të gjitha kutive të cilat kanë kaluar hetimin dhe rinumërimin, të cilat kuti kanë pasur mospërputhje dhe nuk kanë mundur të kalojnë pa u rinumëruar. Ky proces, është bërë për 33 Vendvotime të 14 komunave.